



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.124/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Hedhet poshtë e palejuar ankesa ZL.Anr.124/2025, e datës 07.10.2025, parashtuar nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 07.10.2025, PZAP- i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK në të cilën thekson se më datë 01.10.2025, në Gjykatën Themelore Ferizaj, është paraqitur një padi civile nga Qemajl Aliu ndaj kandidatit të PDK-së, Dr.Përparim Ramusa. Sipas parashtresës, në dokumentacionin e padisë figuron qartë se ajo është protokolluar më numër hyrës dalës në Komunën e Shtimes dhe është vulosur më vulën zyrtare të Komunës. Tutje shton se përdorimi i protokollit dhe vulës së komunës për një proces gjyqësor privat të kryetarit kundër një kundërshtari politik përbën përdorim të burimeve institucionale publike në funksion të interesave partiake dhe ky veprim bie ndesh me nenin 3.4 të Ligjit Nr.03/L-072, cili ndalon përdorimin e

postit dhe burimeve publike në mbështetje të subjektit politik në zgjedhje dhe neni 3 p.5 i këtij ligji ndalon shfrytëzimin e punëtorëve publikë apo resurseve institucionale për fushatën politike . Sipas parashtruesit të ankesës ky akt paraqet keqpërdorim të pozitës publike për të dëmtuar kundërkandidatin politik dhe cenohet barazia e garës zgjedhore dhe përbën precedent të rrezikshëm për integritetin e procesit elektoral .

Si provë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur : padinë e Qemajl Aliu parashtruar kundër kandidatit të PDK-së , Përparim Ramusa.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka kundërshtuar pretendimet në ankesë me arsyetimin se në përmbajtje, ankesa nuk trajton asnjë veprim që lidhet me procesin zgjedhor, me fushatën, me ditën e votimit, apo me ndonjë vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por ka të bëjë me një procedurë të rregullt civile jashtë fushës së kompetencës së Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP). Sipas parashtruesit të ankesës, sipas nenit 115 dhe 117 të Ligjit Nr.08/L228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe neni 4 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave thuhet se PZAP shqyrton vetëm ankesat që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me procesin zgjedhor dhe me zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga PZAP që të marrë vendim meritore për rastin në fjalë dhe ka kërkuar që ankesa e subjektit LVV, të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën, përgjigjen në ankesë, vëren se:

Ankesa është e pa lejuar.

Sipas parashtruesit të ankesës nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës kundër Qemajl Aliu kandidatit për Kryetar të Komunës së Shtimes nga rradhët e Lëvizjes Vetëvendosje , me pretendimin se i njëjti ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit për bie ndesh me nenin 3.4 të Ligjit Nr.03/L-072 , cili ndalon përdorimin e postit dhe burimeve publike në mbështetje të subjektit politik në zgjedhje dhe neni 3 p.5 i këtij ligji ndalon shfrytëzimin e punëtorëve publikë apo resurseve institucionale për fushatën politike. Ndërsa sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se pretendimet ankimore të kësaj natyre nuk bien në kompetencë të fushëveprimit të PZAP.

Neni 115 LZZP parashihet se, PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.

Sipas nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Paneli vlerëson se ankesa në fjalë është e palejuar ngase me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregullat Zgjedhore, PZAP nuk ka kompetencën për te vendosur për shkeljet e pretenduara nga ankuesi.

Prandaj, nga arsyet e theksuar më lartë, në pajtim me nenin 13 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 115 paragraf 1, nenit 119, nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.124/2025, datë 10.10.2025

Kryesuese e Panelit,

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.